

*Ky eshte versioni shqip i Raportit te Perkohshem 2
Por versioni i vetem zyrtar mbetet dokumenti ne anglisht.*

RAPORT I PERKOHSHEM 2 **31 Maj-16 Qershor 2005**

I. PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka regjistruar 27 subjekte zgjedhore qe konkurojne per 40 mandatet, qe do te shperndahen ne listat zgjedhore, dhe KZZ-te kane regjistruar mbi 1,230 kandidate qe konkurojne ne listen nje-emerore ne 100 zonat zgjedhore.
- KQZ vazhdon te drejtoje takimet e saj ne menyre kolegjiale dhe transparente. Ritmi me te cilin KQZ-ja ka miratuar vendimet dhe udhezimet eshte persheptuar dukshem. 100 Komisionet e Zonave Zgjedhore (KZZ) po funksionojne dhe perberja e tyre eshte stabilizuar. Megjithate, ende mbeten disa sfida administrative domethenese, financiare dhe logjistike.
- Eshte thelbesore qe menytrat e monitorimit dhe printimit te fleteve te votimit te sigurojne transparencen maksimale gjate ruajtjes dhe sigurise se ketij procesi. Integriteti i printimit eshte nen pergjegjesine e KQZ-se, dhe garantimi i mundesise qe kontestuesit te monitorojne te gjithe procesin do te rrise besueshmerine e tij.
- Disa parti kane adoptuar strategji zgjedhore per te shfrytezuar te metat ne sistemin zgjedhor. Potencialisht, keto strategji zvogelojne besueshmerine e sistemit zgjedhor ne ndarjen e mandateve ne perputhje me parimet kushtetuese per arritjen maksimale te proporcionalitetit, mjegullojne identitetin politik dhe zvogelojne transparencen e procesit.
- Partia Socialiste (PS) dhe Partia Demokratike (PD), nder te tjera, kane pretenduar qe listat e zgjedhesve po manipulohen per perfitime zgjedhore. Vazhdojne mosmarreshjet lidhur me mos pranimin e studenteve ne listat e zgjedhesve. Cdo pengese e cila mund te coje ne mohimin e se drejtes te studenteve per te votuar duhet te shmanget. Per me teper, numri i madh i hyrjeve ne listat e zgjedhesve (rreth 18%) vendbanimi i te cileve nuk mund te verifikohet (me numer 999), eshte nje ceshtje shqetesuese.
- Leshimi i nje numri te madh te certifikatave te lindjes, te cilat mund te perdoren si mjet identifikimi nga zgjedhesi ne ditet e votimit, ngre shqetesimin se mund te lehtesoje votimin e shumefishte. Probleme te tilla jane me te shpeshta ne vende me numer te madh zgjedhesish me numer "999" ne listen e zgjedhesve.
- Zyra e ODIHR-it – Misioni per Vezhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) nga te dhenat e monitorimit te medias ka konstatuar se, krahasuar me partite e tjera, PD dhe PS kane perfituar me shume kohe televizive ne edicionet e lajmeve sesa u takon me ligj.

- Toni i fushates eshte bere mjaft me i ashper. MVZ po merr nje numer ne rritje pretendimesh te cilat shprehen per shkelje te dipozitave te fushates. Mjaft shqetesuese jane pretendimet se ndaj nepunesve publik dhe studenteve po ushtrohet presion qe te votojne per kandidatet te vecante; gjithashtu jane raportuar pretendime te shumta per blerjen e votave dhe abuzim te burimeve shteterore dhe personelit gjate fushates.
- Kolegji Zgjedhor permbysi pese vendime te KQZ-se per refuzimin e listave partiake. Ligji nuk percakton procedura qe KQZ-ja duhet te verifikojte dokumentat per regjistrim dhe kjo ceshtje nuk u rregullua nga KQZ-ja. Keshtu u shfaqen mosperputhje per te pranuar ose jo listat e partive.

II. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) vazhdon te drejtoje takimet e saj ne menyre kolegjiale dhe transparente. Gjate periudhes se raportimit, vendimet me te rendesishme te KQZ-se konsistojne ne: regjistrimin e listave shume-emerore te partive dhe koalicioneve; masat e sigurise per fletet e votimit; procesverbalet e dorezimit te materialeve; rregullat per deklarimin e shpenzimeve te fushates nga partite, koalicionet dhe kandidatet; dhe manualin e Komisionit te Qendres se Votimit (KQV). KQZ-ja ka perfunduar vendndodhjen e pothuajse te gjitha 100 qendrat e votimit. Megjithate mbeten ende sfidat e rendesishme logjistike dhe administrative, duke perfshire transportimin e kutive te fleteve te votimit per ne qendrat e numerimit te votave. Shumica e autoriteteve te qeverisjes vendore kane dorezuar prane KQZ informacionin e kerkuar per numrin perfundimtar te zgjedhesve dhe numrin perfundimtar dhe vendndodhjen e qendrave te votimit ditën e fundit (dt. 13 Qershor). Sebashku me kerkesat per apel per regjistrimin e kandidatëve, kjo perben nje problem serioz per KQZ-ne per sa i perket printimit dhe paketimit te fleteve te votimit. Ndryshe nga tre zgjedhjet e fundit, fletet e votimit do te prodhohen ne Shqiperi¹. Per te nxitur transparencen e procesit dhe besimin tek aktoret, eshte e nevojshme qe kontestuesit e zgjedhjeve te kene mundesine te vezhgojne printimin e fleteve te votimit pa asnje kufizim.

Levizja Socialiste per Integrim (LSI) eshte ankuar se perberja e KQZ-se reflekton nje ndarje politike dy-partiake dhe si pasoje LSI nuk ka ndikim ne KQZ. LSI-ja eshte vecanarisht e shqetesuar se nuk mund te zevendesojë vezhguesit e saj zgjedhor pas dt. 18 Qershor, ndersa PS dhe PD mund te zevendesojne komisioneret elektorale pothuajse pa kufizime. Shqetesime te tjera lidhen me marrjen e masave per vezhgimin e numerimit te votave gjate zgjedhjeve dhe perdorimin e bojes se padukshme sesa boja permanente per te shenuar gishtin e zgjedhesve.

100 Komisionet e Zonave Zgjedhore (KZZ) po funksionojne dhe perberja e tyre eshte stabilizuar dhe partite kane zevendesuar me pak pjesetaret e KZZ-ve sesa me pare. Megjithate, shume KZZ kane evidentuar probleme teknike dhe logjistike, te cilat mes te tjerave, mund te ndikojne ne transmetimin e rezultateve paraprake ne KQZ. U zhvillua nje seance trajnimit per procedurat e numerimit te votave per kryetaret e KZZ-ve, Zv/Kryetaret dhe trajnuesit. Megjithate, nje numer i madh KZZ-sh raportojne se me 14 Qershor, nuk kane marre fonde, te cilat KQZ-ja kishte vendosur te bente transferimin nepermjet autoriteteve te qeverisjes lokale. Nga 4.763 Qendra Votimi, 786 te tilla kane te regjistruar me shume zgjedhes, mbi 1000 zgjedhes, kufiri i parashikuar nga Kodi Zgjedhor. Mbi 500 qendra jane vendosur ne godina private.

¹ Me pare fletet e votimit printoheshin ne Slloveni. Kompania njoftoi KQZ-ne se nuk mund te garantonte dorezimin ne kohe te fleteve te votimit si pasoje e vonesave ne finalizimin e kapacitetit dhe faqesjes e fleteve te votimit

Interlokutoret nga krahina te ndryshme te vendit kane shprehur shqetesimin e tyre se leshimi i certifikatave te lindjes - e cila eshte nje nga tre dokumentat e identifikimit per secilin zgjedhes

ne KQV - mund te lehtesoje votimin e shumefishte. Shqetesime te tilla jane me te shpeshta ne zona me numer te larte zgjedheshish me numer "999" ne listen e zgjedhesve; vecanerisht ne vendet ku nje numer i konsiderueshem emigrantesh mendohet te jene ne listen e zgjedhesve. Mbetet nje problem shqetesues, vecanerisht sepse certifikatat e lindjes mund te terhiqen me lehtesi dhe mund te kerkohen edhe ne emer te pjesetareve te familjes. Me sa eshte raportuar, identiteti i aplikantit shpesh vetem kontrollohet ne menyre jo formale/siperfaqesore. Ne Shkoder, Vezhguesve Afatgjate u eshte thene se zyra e gjendjes civile nuk mban shenime per certifikatat e lindjes te leshuara, por qe zyra ka marre 110.000 formulare ne Tetor 2004, nga te cilat vetem 20.000 jane perdorur.

III. REGJISTRIMI I ZGJEDHESVE

Duke ndjekur mbylljen e listave paraprake me 30 Maj, kryetaret e bashkive duhej qe deri me 8 Qershor te benin te gjithe ndryshimet dhe te pergatitnin versionet perfundimtare te listave te zgjedhesve per njesite e qeverisjes vendore perkatese. Listat perfundimtare te zgjedhesve duhet te ishin marre nga KZZ-te dhe te shpalleshin publikisht jo me vone se 13 Qershor. Vezhguesit raportuan se KZZ-te nuk ishin ne gjendje te permbushnin kete kerkese ne menyre uniforme, me marrjen e vonuar te listave nga disa KZZ-te, gje e cila shkaktoi vonese ne publikimin e listave ne disa zona elektorale.

Sipas Ministris se Qeverisjes Vendore dhe Decentralizimit, ne listat paraprake figuronin 2.879.602 te regjistruar. Megjithate, 203.034 regjistrime u identifikuar si "regjistrime te mundshme te perseritura". Ky numer korrespondon me rreth 100.000 qytetare te regjistruar. Me 8 Qershor, regjistrimi i 83 630 qytetareve u zgjidh, dhe keta qytetare rezultojne te regjistruar vetem nje here.

Zyra e OSCE/ODIHR MVZ eshte informuar se 528.000 regjistrime u perkon nje numer adrese "999"ose "888" (rreth 18 % te te gjitha regjistrimeve)². Keto regjistrime u korrespondojne personave, te dhenat e te cileve ndodhen ne regjistrin themeltar/civil, por te cilet "nuk mund te kontaktoheshin" gjate procesit te verifikimit dhe identifikimit te zhvilluar ne periudhen Nentor 2004 – Shkurt 2005³. Listat e zgjedhesve ne 291 njesi te qeverisjes vendore nga 383 te tilla, permbajne rekorde te tilla. Rreth 40.000 tipe te tilla rekordesh ishin pastruar gjate procesit te pastrimit te te dhenave.

PS dhe PD si dhe LSI jane ankuar se listat e zgjedhesve po manipulohen per perfitime elektorale. PS ka pretenduar qe Bashkia e Shkodres nuk ka vepruar sipas urdherit te Gjykates se Rrethit persa i perket rishikimit te listave te zgjedhesve, te cilet perfshinin me shume se 5.000 persona me numer adrese qe perfundon me "999". Partia deklaroi se probleme te ngjashme ekzistojne edhe ne bashki te tjera te administruara nga opozita. PD ka hedhur pretendime te ndryshme per qytetare te cilet nuk jane regjistruar ne lista duke perfshire Durresin dhe Tiranen (zona 33). Persa i perket rastit te fundit, PD pretendon, dhe ka paraqitur prova, se rreth 2.100 persona te rregullt jane lene te paregjistruar ne listat e zgjedhesve. MVZ-e ka pare te paarsyeshme lenien e tyre jashte listave.

Vendimi i marre nga Kryetari i Minibashkise 2 ne Tirane per mosregjistrimin e 1.422 studenteve te Universitetit te Tiranës ishte shume kontradiktor. Si rezultat i vendimit te Kryetarit, per te

² Nga keto, 90.000 hyrje lidhen me regjistrimin e qytetareve ne komunat rurale dhe 438.000 te regjistruar ne bashki.

³ Tre shifrat e fundit te kodit dhjete-shifror normalisht identifikojne banesen e votuesit, duke mundesuar qe te dhenat te hyjne ne nje database elektronik te regjistrimit te votuesve.

votuar, studentet duhet te udhetojne ne vendet e tyre ku kane banesen e perhershme (duke supozuar qe ata jane te regjistruar atje si zgjedhes). Zgjedhjet do te zhvillohen ne periudhe sezoni

provimesh, dhe disa prej tyre do te jene te detyruar te zgjedhin mes te drejtes se tyre per te votuar dhe provimeve perfundimtare. Per tu theksuar eshte se nje Dekan i Universitetit te Tiranës eshte kandidat i PD dhe qe Kryebashkiaku eshte zgjedhur nga rradhet e PS. Cdo pengese e cila mund te coje ne mohimin e se drejtes se studenteve per te votuar eshte aspak e mirepritur.

LSI dhe PD kane pohuar nje rast te tille per zonen 33, ku studenteve iu ishte mohuar e drejta per tu regjistruar per zgjedhjet, si pasoje e deshtimit te zyrtareve te universitetit per te permbushur detyrimet ligjore per regjistrimin e studenteve. MVZ po kerkon informacione per shqyrtimin e ketij pretendimi. Me fjale te tjera, procedurat qe bejne te mundur regjistrimin e studenteve duket se eshte zbatuar dhe publikuar ne menyre jo te barabarte.

IV. REGJISTRIMI I KANDIDATEVE

Gjate fundit te Majit dhe ne fillim te Qershorit, KQZ-ja regjistroi listat e partive dhe koalicioneve dhe KZZ regjistruan kandidatet per 100 zonat zgjedhore. Eshte regjistruar lista me 17 partite Parlamentare, ku perfshihen edhe Partia e Ballit Kombetar dhe Partia e Sigurise Kombetare. Secila nga keto parti beri nje deklarate nga nje parlamentar ne detyre, qe eshte anetar i asaj partie. Sidoqofte, qe te dy parlamentaret konkurojne per parti te tjera ne keto zgjedhje. KQZ-ja i pranoi keta vendime si te mireqena.

Pervec partive politike parlamentare, 17 parti dhe koalicione jo-parlamentare dorezuan listat e kandidateve prane KQZ-se. Ashtu sic e kerkon ligji, dorezimet u shoqeruan me listat e firmave⁴ nga mbeshtetesit. Megjithate, Kodi Zgjedhor nuk parashikon se si keto firma do te verifikohen nga KQZ-ja. Ligji i jep KQZ-se vetem 48 ore kohe per te verifikuar vertetesine e dokumentave te dorezuar. KQZ-ja nuk miratoi ndonje rregullore se si do ta drejtoje kete proces. Ajo vendosi te shqyrtonte disa shembuj te ketyre regjistrimeve (fillimisht dhjete, pastaj 50 per liste) per te vendosur nese keta persona ishin ne listat paraprake te zgjedhesve. Me 3 Qershor, KQZ-ja i dorezoi nje kerkese me shkrim policise gjyqesore per te kontrolluar nese ka firma identike te shumefishuara. Policia vertetoi se te gjitha listat permbanin firma te perseritura nga persona te njejte.

KQZ-ja pati nje mungese te vazhdueshme metodologjie ne marrjen e vendimeve nese duhen pranuar apo refuzuar 17 listat. Dymbedhjete lista u refuzuan, dhe dy u regjistruan⁵. Tre partive iu dha kohe shtese per sjelljen e dokumentave shtese, dhe dy u pranuan, te tjerat u refuzuan. Kolegji Zgjedhor permbyysi pese vendime te KQZ-se per mospranimin e listave partiake (shih seksionin e ankesave dhe apeleve)⁶. Gjate kohes qe ky raport eshte perpiluar, pas nje numri apelesh te sukseshem, 27 subjekte elektorale (18 parti qe garojne vecmas, dy koalicione me lista te perbashketa, dhe nje koalicion me shtate parti me liste te perbere, permes te ciles partite prezantohen vecmas ne fletet e votimit) kane patur lista te kandidateve te regjistruar nga KQZ⁷.

⁴ Ligji kerkon qe partite te marrin 7.000 firma te vlefshme dhe koalicionet 10.000 firma te vlefshme.

⁵ Lista e "Lidhjes se Blerte Shqiptare", u pranua pasi partia mori deshmi te noterizuar qe qytetaret kane firmosur ne vend te familjareve te tyre, megjithese kjo praktike nuk eshte e parashikuar ne Kodin Elektorale.

⁶ Kolegji Zgjedhor i ktheu KQZ-se dy vendime (vecmas) te kerkeses se Partise se Ballit Kombetar per tu bashkuar me Koalicionin per Liri, Drejtesi dhe Mireqenie, meqe asnjeri nga vendimet nuk kishte kater votat e nevojshme. Votimi i trete i KQZ-se me 17 Korrik ishte 4 me 3 vota duke rrezuar kerkesen e Partise Balli Kombetar. Ky vendim mund te apelohet ne Kolegjin Zgjedhor.

⁷ Nje parti lista e te ciles nuk eshte regjistruar i ka bere peticion Gjykates Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese nuk ka vendosur per pranimin e rastit.

KZZ-te kane regjistruar 1.235 kandidate qe konkurojne ne 100 zonat e mandateve nje-emerore, duke perfshire edhe 11 kandidate te pavarur. KQZ-ja ka marre 17 kerkese-apele lidhur me vendimet e KZZ-ve per te regjistruar ose refuzuar kandidatet. KQZ-ja ka mbeshtetur shtate kerkese-apele, ka refuzuar kater ceshtje ne themel dhe dy prej tyre per mungese provash plotesuese. Kater kerkese-apele kane qene ne proces ose jane terhequr.

Disa kandidate te cilet kane pozicione shteterore kane dhene doreheqjen nga postet e tyre sipas Nenit 69 te Kushtetutes. Megjithate, partite opozitare dhe partia ne fuqi jane ankuar publikisht per konflikte interesash dhe keqperdorime te burimeve shteterore nga kandidatet, te cilet jane nepunes civil (psh. Dekanet e Universiteteve dhe zyrtare te Doganave ose te Policise).

V. STRATEGJITE ZGJEDHORE TE PARTIVE

Disa parti kane pershtatur strategji zgjedhore per te shfrytezuar dobesite e sistemit zgjedhor si dhe lehtesine e tij per te abuzuar. Potencialisht, keto strategji ulin besueshmerine e sistemit zgjedhor per te shperndare mandate ne perputhje me parimet kushtetuese per maksimumin e proporcionalitetit, duke mjegulluar identitetin politik. Per nje analize te detajuar, ju lutem shihni Aneks 1.

Partia ne drejtim (PS) ka regjistruar kandidatet e saj dhe listat partiake vecmas nga aleatet e saj te mazhorances parlamentare (Partia Socialdemokrate, Partia per Demokraci Sociale, Partia Agrare Ambientaliste, Partia Aleanca Demokratike dhe Partia Bashkimi per te Drejttat e Njeriut)⁸. Keto pese parti aleate gjithashtu konkurojne ne keto zgjedhje si subjekte elektorale te vecuara ne zona elektorale dhe ne nivel kombetar. Nuk eshte formuar ndonje marreveshje koalicioni formal mes partive ne fuqi. Partia Socialiste vazhdimisht ka deklaruar se nuk do te perdore asnje strategji te tipit "Dushk". Megjithate, sic u permend edhe me pare, PS informoi zyren e ODIHR MVZ se ajo nuk e perjashton mundesine qe mund te arrihen marreveshje politike ne nivel lokal. Pervec kesaj, nje nga partite e koalicionit drejtues tregoi per ODIHR MVZ, qe bashkepunimi midis PS dhe koalicionit drejtues eshte i domosdoshem dhe praktikisht do te ndodhe.

Partia Demokratike ka perfunduar marreveshje te shkruara me shtate parti politike te tjera (aleatet e PD-se) me ane te se ciles PD dhe aleatet e saj do te prezantojne nje kandidat nen emrin e PD-se. Formalisht, Partia Demokratike, do te kete 100 kandidate konkurent ne zonat elektorale sic e kerkon ligji⁹. Megjithate, me ftese te PD, pesembedhete nga keta kandidate ishin *de facto* nominuar nga aleatet e PD-se. Simpatizantet e PD-se dhe te aleateve te saj po inkurajohen te mbeshtesin keta kandidate. Strategjia duket se synon te maksimizojte numrin e mandateve nje-emerore qe mund te fitohen nga partite e krahut te djathte nen flamurin e PD-se.

Ne listen zgjedhore kombetare, Partia Demokratike ka regjistruar listen e saj vecmas nga shtate aleatet e saj. Keto shtate parti aleate kane formuar nje koalicion "Koalicioni per Liri, Drejtesi dhe Mireqenie", i cili eshte regjistruar si liste zgjedhore shume emerore e perbere¹⁰. Simpatizantet e PD-se dhe aleateve te saj po inkurajohen te votojne per listen zgjedhore te koalicionit sesa per

⁸ Anetaret e koalicionit drejtues jane: Partia Socialiste (PS), tre partite e fundit perfituan nga ngjarjet e Dushkut ne vitin 2001, gje e cila i siguroi atyre te kalojne pragun e 2.5%.

⁹ Shih Nenin 15 te Kodit Zgjedhor.

¹⁰ Lista e perbere shume-emerore ben te mundur qe partite te garojne si nje koalicion duke qendruar si subjekte elektorale te vecuara ne fletet e votimit. Partite ne koalicion duhet te marrin ne total 4% te votave, por partite politike nuk kane nevoje te arrijne secila 2.5% te votave.

listen e PD-se. Strategjia duket se synon te maksimizoje numrin e mandateve plotesuese qe PD-ja dhe aleatet e saj do te marrin, duke shfrytezuar mangesite e Nenit 67 te Kodit Zgjedhor.

Keto strategji jane diskutuar shume dhe kritikuar ashper, vecanerisht nga LSI-ja¹¹, ndersa PS dhe PD kane shprehur kritika te perbashketa kundrejt qendrimet perkates ndaj kontekstit zgjedhor. Media ka mbuluar kete ceshtje, deri tani ka pasur pak diskutime nese strategjite jane etike apo te ligjshme.

Ne raste ekstreme, disa strategji zgjedhore te partive politike mund te keqperfaqesojne perkatesine politike te kandidatave dhe ne kete menyre te drejtojne gabim zgjedhesit¹². Per me teper te ulin besimin e zgjedhesve ne aftesine e sistemit zgjedhor per te reflektuar zgjedhjen e tyre elektorale ne mandate sipas parimit te perfaqesimit parashikuar ne Kushtetute. MVZ do te vleresoje nese partite i tejcojne publikut strategjite e tyre elektorale ne menyre transparente. Nje metode e tille mund te permiresoje procesin zgjedhor dhe ndergjegjesoje zgjedhesit ne zgjedhjet e tyre elektorale.

Ndersa partite e perfshira ne strategji te tilla mund te jene brenda ligjit, veprimet e tyre i shmangen qellimit te tij dhe shfrytezohen defektet e tij. Nese te sukseshme, strategjite e tyre mund te ndikojne ne menyre domethenese ne ndarjen e mandateve dhe uljen e efikasitetit te Nenit 67 per permbushjen e qellimeve Kushtetuese ne arrijten e proporcionalitetit sa me afer qe te jete e mundur.

VI. FUSHATA ELEKTORALE

Ne shume zona elektorale, partite – vecanerisht partite e medha – po organizojne fushata aktive dhe te dukshme. Partite e medha po organizojne mitingje ne te gjitha vendin. Deri tani, eshte respektuar liria e nje grupimi paqesor. Shume parti kane informuar vezhguesit, qe qellimi eshte te perqendrojne perpjekjet e tyre ne fushate duke u takuar me elektoratin shtepi per shtepi. Misioni per Vezhgimin e Zgjedhjeve ka vene re ne Durres, qe jane shperndare materiale elektorale te cilat u bejne thirrje simpatizanteve te PD dhe PR te ndajne votat e tyre – te votojne ne favor te kandidatave te PD ne zonat nje-emerore dhe per listen e Partise Republikane.

Ne pergjithesi, ‘toni’ i fushates eshte bere me i ashper dhe MVZ ka marre nje numer pretendimesh gjithnje ne rritje, per thyerje te klauzolave ligjore dhe disa probleme serioze po shfaqen gjate fushates. Teper shqetesuese jane: pretendimet e percjella ne Durres, Tirane, Kukës dhe Gjirokaster, ku nenpunesit publike jane detyruar qe te votojne per kandidatave te vecante dhe qe studentet ne Tirane dhe Korce kane qene nen tensionin per te votuar per zyrtare te Universitetit, te cilet po kandidojne.

MVZ eshte vene ne dijeni te pretendimeve per blerje te votes (p.sh; ne Shkoder, Kukës, dhe Lezhe), dhe nje numer pretendimesh – disa prej te cilave jane vertetuar – per keqperdorim te burimeve shteterore dhe personelit per qellime te fushates (p.sh; ne Gjirokaster, Durres dhe Tirane). Ne Berat dhe Tirane ka pasur akuza per organizime te fushates ne shkolla. Ne qofte se kjo vertetohet, keto veprime shkelin paragrafin 7.7 te Dokumentit te Kopenhagenit te OSBE-se.

¹¹ Duke qene se ka nje numer te percaktuar te mandateve plotesuese, ata parti te cilat kalojne pragun e perfaqesimit por operojne jashte koalicioneve dhe aleancave formale dhe joformale, mund te marrin me pak mandate se pjesa qe teorikisht i takon nga Neni 67.2.b.

¹² Eshte me vlere te theksohet qe Partia Republikane (nje nga partite brenda koalicionit per Liri, Drejtesi dhe Mireqenie) permban emrat e 30 anetareve te PD-se, perfshire edhe anetare te Parlamentit (te zgjedhur nen emrin e PD-se ne Parlamentin aktual) dhe pjesetare te Komitetit te Orientimit te Politikave te PD-se.

Vezhguesit kane raportuar qe zyrat e parties ne Korce, Shkoder dhe Tirane jane sulmuar ne menyre vandale dhe kane ndodhur 3 incidente dhune: me dt. 5 Qershor ne Lezhe, nje gazetar u sulmua gjate nje mitingu te PD; me dt. 7 Qershor ne Sarande, u sulmua nje kandidat i PD, pretenduar nga Partia e Bashkimit te Drejtave te Njeriut; dhe me dt. 9 Qershor ne Fier, ndodhi nje rrahje midis simpatizanteve te PS dhe LSI, per te cilat eshte bere dhe ankese zyrtare.

Me ligj, kandidatet nuk jane te detyruar te raportojne burimet e tyre per financimin e fushates deri 45 dite pas zgjedhjeve. Disa kandidate kane informuar vezhguesit qe ata vete-financojne fushaten e tyre.

VII. MEDIA

Media mbulon fushaten elektorale ne teresi: lajmet, edicionet speciale, bisedat televizive dhe debatet. TVSH filloi transmetimin e minutazhit falas per partite politike. Te dhenat monitoruese te zyres se medias prane ODIHR-it MVZ (per periudhen 3-14 Qershor) tregojne qe gjate lajmeve PD dhe PS (duke perfshire anetaret e qeverise qe po kandidojne) perfitojne me teper minutazh sesa e drejta e tyre ligjore (krahasuar me partite e tjera parlamentare). PS dhe PD ne pergjithesi ka nje shperndarje te barabarte minutazhi ne edicionet e lajmeve. Dy partite kryesore gjithashtu mbizoterojne edhe ne bisedat televizive dhe debatet politike. Ne teresi, media mbulon ceshtjet politike ne nje menyre neutrale dhe te moderuar. Nje numer kanalesh lokale televizive transmetojne debate midis kandidateve ne zonat elektorale nje-emerore.

Bordi Monitorues i Medias (BMM) filloi punen e tij monitoruese me dt. 3 Qershor, dite qe filloi dhe periudha zyrtare e fushates. BMM paraqet prane KQZ raporte ditore mbi sasine e mbulimit ne median elektronike te subjekteve elektorale. Me dt. 7 Qershor, bordi njoftoi qe PS kishte perfitur nje minutazh me te madh sesa PD ne transmetimet e kanaleve publike TVSH dhe disa kanale televizive private. BMM gjithashtu shprehu shqetesimin qe partite me me pak se 20% te vendeve ne parlament perfitonin nje minutazh teper te vogel ne median elektronike. Ne kundershiti me kete, BMM perfshin spotet e paguara ne perlllogaritjen e minutazhit te perfitur nga partite.

PD paraqiti nje ankese prane KQZ dhe BMM lidhur me transmetimin nga TVSH te fjalimit prej 45 minutash nga Kryeministri Fatos Nano. Ndersa TVSH u perpoq qe te 'kompensonte' PD, partia nuk mbeti e kenaqur me vendimin e njeanshem te TVSH per te transmetuar kroniken nga arkivi, pasi me mire do kishte qene transmetimi i nje kronike nga fushata aktuale. Perfundimisht, KQZ i kerkoi TVSH te siguronte kohe kompensimi (me nje permbajtje dhe kohe te njejte) per PD brenda 48 oreve. Ankesa te tjera jane dorezuar nga subjekte elektorale per transmetime jo te balancuara dhe KQZ pas shqyrtimit te raporteve te BMM u kerkoi kanaleve transmetuese te ribalancojne raportin e minutazhit.

VIII. KONFLIKTE ELEKTORALE

Pese nga 1,422 studente u lane jashte listes se zgjedhesve ne Zonen 2, Tirana apeloj ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor, Tirane kunder vendimit te Kryetarit te Bashkise (shiko seksionin IV). Si rrjedhoje, PD dorezoi nje kerkese prane KQZ per marrjen e sanksioneve ndaj Kryetarit te mini-bashkise per mosperfshirjen e studenteve in listat e zgjedhesve. Me dt. 9 Qershor, Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Tirane vendosi ne favor te pese studenteve. Megjithate, edhe pse gjykata e pa te arsyeshme qe vendimi i kryetarit te mini-bashkise duhej shfuqizuar, vendosi vetem per perfshirjen e pese studenteve, te cilet kishin paraqitur apelimin zyrtar. Edhe keta pese studente mund te mos

perفشihen ne listat e zgjedhesve, per shkak te kerkeses per printimin e listave te zgjedhesve me dt. 8 Qershor. Eshte problematike qe keta studente nuk u perfshine ne listat e zgjedhesve, jo per ndonje faj te tyre, por per shkak te veprimeve te autoriteteve qeveritare. KQZ eshte ende ne proces te kerkeses per denimin e kryetarit te minibashkise dhe ka kerkuar te gjithë dokumentacionin perkates nga autoritetet qeveritare te perfshira ne proceset per regjistrimin e studenteve zgjedhes.

Qe nga fillimi i fushates zgjedhore, jane ankimuar prane Kolegjit Elektoral 20 kerkesa per apel kunder vendimeve te KQZ. Nje kerkese per apel u terhoq nga paditesi perpara marrjes se vendimit, nje tjeter u vendos nga Kolegji per mungese te bazes ligjore dhe nuk eshte marre ende vendimi per kater te tjera. Per 14 kerkesat e tjera eshte marre vendimi. Nga keto, Kolegji miratoi shtate vendime te KQZ, permbysi pese vendime dhe ktheu dy vendime prane KQZ per nje shqyrtim te ri. Pese vendimet e KQZ te cilat u shfuqizuan nga Gjykata kishin lidhje me mosregjistrimin e listes shumeemeroje te partive per shkak te firmave mbeshtetese te diskutueshme (psh, fallsifikime te dukshme, duplikime dhe probleme te tjera te cilat sugjeronin qe disa firma ne liste nuk ishin te vlefshme). Kolegji Elektoral vendosi qe lista e partive duhet te perfshihet ne fleten e votimit, sepse numri i firmave te diskutueshme nuk pruri ndonje liste nen numrin e kerkuar dhe si rrjedhoje nuk kishte baza objektive per te arritur ne perfundimin qe partite kishin deshtuar ne permbushjen e kriterit te regjistrimit. Gjate seancave degjimore, disa parti u ankuan qe KQZ nuk kishte njoftuar partite dhe koalicionet se kur do te merrte vendimin per regjistrimin e listes se partive. Ato parti qe kane qene te pranishme ne takimet perkatese te KQZ paten mundesine per te siguruar materiale shtese. Ato parti dhe koalicione, te cilat nuk ishin te pranishme kur listat e tyre u moren ne konsiderate, nuk e paten kete mundesi.

IX. CESHTJET GJINORE DHE PAKICAT KOMBETARE

Pjesemarrja e grave ne zgjedhje eshte shume e ulet. Vetem 95 kandidatet femra jane regjistruar ne zonat zgjedhore nje-emeroje (me pak se 8%) dhe vetem 141 jane pjesemarrrese ne listat partiake (me pak se 9%). MVZ po ndjek nga afer ceshtjet elektorale qe ndikojne ne pjesemarrjen e gruas ne jeten publike.

Historikisht, Partia Bashkimi i te Drejtave te Njeriut (PBDNJ) ka kerkuar mbeshtetjen politike te pakicave kombetare, ka nxitur ceshtje qe i perkasin minoriteteve, dhe ka paraqitur nje numer te madh kandidatësh nga popullata minoritare. MVZ ka vene re qe PD gjate fushates ka permendur problemet me te cilat jane ndeshur popullata Rome dhe Egjiptiane. Gjate zgjedhjeve te meparshme disa komunitete rome jane ankuar qe disa rome nuk jane perfshire ne listen e zgjedhesve dhe shume prej tyre te regjistruar nuk ishin te pajisur me dokumentin e duhur te identifikimit e kerkuar ne votime. MVZ ndjek nga afer ceshtjet zgjedhore qe ndikojne pakicat.

ANEKSI 1: SISTEMI ZGJEDHOR

Kushtetuta vendos parimet kryesore te sistemit zgjedhor, te cilat duhen zbatuar nga legjislativi kur harton ligjet, ne menyre me specifike:

Kuvendi perbehet nga 140 deputete, me 100 deputete (71%) te zgjedhur ne zona nje-emerore dhe 40 deputete (29%) te zgjedhur nga listat e partive ose te koalicioneve;

“Numri i pergjithshem i deputeteve te cdo partie [...] duhet te jete ne raport sa me te afert me votat e vlefshme te marra prej tyre ne te gjithë vendin [...]”; dhe

Partite marrin te pakten 2.5% te votave dhe koalicionet e partive marrin te pakten 4% te votave te vlefshme, per te marre pjese ne ndarjen e 40 vendeve per listat e partive dhe koalicioneve.

Kuvendi duhet te pershtase ligjin zgjedhor qe shtjellon me gjere sistemin zgjedhor dhe qe respekton keto parime. Ndersa Neni 65 i Kodit Zgjedhor shpreh qe 40 ‘mandatet plotesuese’ ndahen: “sipas perqindjes propocionale te votave te fituara nga listat shume-emerore,” sistemi zgjedhor Shqiptar nuk eshte nje sistem paralel. Neni 67 i Kodit Zgjedhor shpreh qe 40 mandatet plotesuese ndahen ne menyre te tille qe numri i pergjithshem i deputeteve (140) i shperndare midis partive, do te percaktohet ne menyre sa me te afert me perqindjen e votes te marre nga listat e tyre elektorale.

Ndarja e 40 ‘mandateve plotesuese’ lidhet me numrin e mandateve te fituara nga nje parti ose koalicion ne zonat elektorale nje-emerore (mandatet e mazhoritarit). Neni 67.1.b percakton qe numri i votave te vlefshme te fituara nga cdo parti ose koalicion, qe kalon prapun perkates, pjesetohet me shumen e votave te vlefshme, te fituara prej tyre ne shkalle vendi, p.sh; numri i pergjithshem i votave te vlefshme per te gjitha partite qe kane kaluar prapun shumezuar me 140 (numri i pergjithshem i deputeteve ne parlament). Kjo percakton nje “te drejte mandatesh ideale” me ane te te cilit parlamenti formohet mbi parimin e perfaqesimit propocional.

Kodi Zgjedhor percakton perdorimin e dy votave (nje per kandidatet ne zonat nje-emerore dhe tjetra per listat e partive ose te koalicionit) dhe si rrjedhoje zgjedhesit lejohen te bejne 2 zgjedhje te vecanta zgjedhore. Sipas Nenit 67, ne qofte se numri i mandateve te mazhoritarit fituar nga cdo parti/koalicion kalon numrin total te mandateve qe u ‘takon’ (sipas Nenit.67.1.b), partia/koalicioni nuk do te perfitojne nga 40 vendet plotesuese. Partite/koalicioni mbajne mandatet nje-emerore te fituara pavaresisht nga perqindja e votave per listen e tyre.

Shkalla e proporcionalitetit e shprehur nga Kushtetuta ne formimin e parlamentit kufizohet nga 3 faktore. E para eshte pamundesia per te zvogeluar perfitimet e partise ne zonat zgjedhore nje-emerore. E dyta eshte masa e paracaktuar, 40 vendet, e instrumentit per te arritur “proporcionalitetin me te afert”. Faktori i trete eshte masa e ketij instrumenti, 40 vende nga 140, ose 29%. Kombinimi i ketyre faktoreve, se bashku me vete sistemin zgjedhor te komplikuar, eshte e vecante per zgjedhjet ne Shqiperi.

Neni 67 duket sikur ka per qellim te realizoje objektivin kushtetues per te arritur maksimalisht perfaqesimin proporcional (sic shprehur ne Nenin 64.2)¹³. Megjithate, dispozitat e Kodit Elektoral nuk jane perfekte ne arritjen sa me afer te perfaqesimit propocional. Per shkak se zgjedhesit kane dy zgjedhje elektorale, partite mund t’i devijojne qellimit te Nenit 67 te Kodit Elektoral duke zhvilluar strategjite politike me partite aleate formale ose joformale. Ne qofte se te sukseshme,

¹³ Ne vitin 2001, Gjykata Kushtetuese nxori nje rregull per kushtetueshmerine me nje formule te ngjashme (Neni 66 i Kodit Zgjedhor 2000). E cila shqyrtoi se ndersa mund te kete nje formule per shperndarjen e mandateve e cila do te conte ne nje shkalle me te larte proporcionaliteti, formula (e ngjashme me ate te shprehur ne Nenin 67 te Kodit Zgjedhor 2005) permbush kerkesat kushtetuese te proporcionalitetit te shprehur ne Nenin 64.2 te Kushtetutes.

keto strategji do te sillnin si rezultat me pak mandate caktuar partive rivale, pasi eshte vetem nje numer i caktuar mandatesh plotesuese per tu shperndare. Pervec perpjekjeve ne vitin 2001 per te manipuluar sistemin zgjedhor, dispozitat ligjore ne ndarjen e mandateve plotesuese mbeten mjaft te pandryshuara.

Me poshte permenden kater shembuj per te ilustruar ndikimet e medha ne ndarjen e mandateve plotesuese dhe perfaqesimin ne menyre jo proporcionale e perlllogaritur duke zbritur midis perqindjes se votave dhe perqindjes se vendeve.¹⁴

Shembull 1: Ne kete shembull, partia A ka fituar me shume mandate ne mazhoritar (54) dhe numrin me te madh te votave. Asnje strategji nuk aplikohet nga partite.

Partia	Nr. i votave	% e votave	Mandatet e mazhoritarit dhe % e te 140 vendeve	Mandatet plotesuese	Mandate ne Total	% e te gjithe mandateve	Diferenca (mes % se votave dhe % se mandateve)
A	400.000	40%	54 (38,6)	4	58	41.4%	+1.4%
B	300.000	30%	42 (30)	2	44	31.4%	+1.4%
C	140.000	14%	2 (1.4)	18	20	14.3%	+0.3%
D	70.000	7%	0	9	9	6.4%	-0.6%
E	50.000	5%	0	7	7	5%	0%
F	15.000	1.5%	1 (0.7)	0	1	0.7%	-0.8%
G	15.000	1.5%	1 (0.7)	0	1	0.7%	-0.8%
H	10.000	1.0%	0	0	0	0	-1.0%
TOTAL	1.000.000	100%	100	40	140	100	-

Disproporcioni total: 2.1%

Shembull 2: Ne kete shembull, partia A, nxit simpatizantet e saj per te votuar (ne listat e partive) jo per partine A, por per partine E. Partia B ndjek nje metode te ngjashme duke nxitur simpatizantet e saj te votojne per partite F dhe G. Numri i vendeve ne mazhoritar eshte i njejte si ne shembullin 1.

Partia	Nr. i votave	% e votave	Mandatet e mazhoritarit dhe % e te 140 vendeve	Mandatet plotesuese	Mandate ne Total	% e te gjithe mandateve	Diferenca (mes % se votave dhe % se mandateve)
A	200.000	20%	54 (38.6)	0	54	38.6%	+18.6%
B	150.000	15%	42 (30)	0	42	30.0%	+15.0%
C	140.000	14%	2 (1.4)	8	10	7.1%	-6.9%
D	70.000	7%	0	4	4	2.9%	-4.1%
E	250.000	25%	0	16	16	11.4%	-13.6%
F	90.000	9%	1 (0.7)	6	7	5%	-4%
G	90.000	9%	1 (0.7)	6	7	5%	-4%
H	10.000	1%	0	0	0	0	-1%
TOTAL	1.000.000	100%	100	40	140	100%	-

Disproporcioni Total: 29.1%

¹⁴ Niveli i disproporcionalitetit eshte llogaritur me formulen, e cila percakton distancen mes pikave ne nje hapsire Euklidiane n-dimensionale: $\Delta = \sqrt{\sum (V_i - S_i)^2}$, $i = 1, 2, \dots, N$,

Shembull 3: Ne kete shembull, partia A ka marre perqindjen me te madhe te votave ne listen partiake, po ka marre me pak mandate kushtetuese ne mazhoritar sesa patia B. Asnje strategji politike nuk po aplikohet nga ndonje parti.

Partia	Nr. i votave	% e votave	Mandatet e mazhoritarit dhe % e te 140 vendeve	Mandatet plotesuese	Mandate ne Total	% e te gjithe mandateve	Diferenca (mes % se votave dhe % se mandateve)
A	400.000	40%	42 (30)	12	54	38.6%	-1.4%
B	300.000	30%	54 (38.6)	0	54	38.6%	+8.6%
C	140.000	14%	2 (1.4)	15	17	12.1%	-1.9%
D	70.000	7%	0	8	8	5.7%	-1.3%
E	50.000	5%	0	5	5	3.6%	-1.4%
F	15.000	1.5%	1(0.7)	0	1	0.7%	-0.8%
G	15.000	1.5%	1(0.7)	0	1	0.7%	-0.8%
H	10.000	1.0%	0	0	0	0	-1%
TOTAL	1.000.000	100%	100	40	140	100	-

Disproporcioni total: 9.1%

Shembull 4: Ne kete shembull, partia A nxit simpatizantet e saj te votojne (ne listat e partive) jo per partine A, por per partine E. Partia B ndjek nje metode te ngjashme, dhe nxit simpatizantet e saj te votojne per partine F dhe G. Numri i mandateve te mazhoritarit eshte i njejte me ato te shembullit 3.

Partia	Nr. i votave	% e votave	Mandatet e mazhoritarit dhe % e te 140 vendeve	Mandatet plotesuese	Mandate ne Total	% e te gjithe mandateve	Diferenca (mes % se votave dhe % se mandateve)
A	200.000	20%	42 (30)	0	42	30.0%	+10.0%
B	150.000	15%	54 (38.6)	0	54	38.6%	+23.6%
C	140.000	14%	2 (1.4)	8	10	7.1%	-6.9%
D	70.000	7%	0	4	4	2.9%	-4.1%
E	250.000	25%	0	16	16	11.4%	-13.6%
F	90.000	9%	1 (0.7)	6	7	5%	-4%
G	90.000	9%	1 (0.7)	6	7	5%	-4%
H	10.000	1%	0	0	0	0	-1%
TOTAL	1.000.000	100%	100	40	140	100	-

Disproporcioni total: 30.6%

Disa komente mbi strategjite elektorale te paraqitura ne tabelat e mesiperme:

- Kur aplikohen strategji (shembujt 2 dhe 4), diferenca mes perqindjes se votave dhe perqindjes se mandateve (disproporcioni) rritet ndjeshem;
- Nga strategji te tilla perfitojne partite te cilat i perdorin ata. Partite te cilat nuk perdorin ose nuk mund te perdorin strategji te tilla marrin nje numer me te vogel nga 40 mandatet;
- Ndonjehere strategjite e partive ose koalicioneve partiake mund te mjegullojne dallimet mes partive politike;
- Keto strategji mund te funksionojne vetem duke ulur efikasitetin e Nenit 67 te Kodit Zgjedhor ne qellimin e tij; dhe;
- Prandaj, keto strategji demtojne objektivat kushtetuese per te arritur proporcionalitetin sa me afer qe te jete e mundur ne perberjen parlamentare (140 vendeshe).